



Prishtinë: 12.02.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1236_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2009_12_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.01.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 12.02.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N. H. nga fshati Raskovë, Kastriot, me shifër të konsumatorit DPR - 56321 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2009_12_19** i datës 16.12.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.01.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: korrigjimi plotësues i datës 28.07.2017 është korrigjim i saktë dhe real, bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi, pasi që njehsori elektrik ka regjistruar shpenzim të energjisë elektrike për 33.33% më pak. KESCO në ankesë ka theksuar se nuk pajtohet me argumentet e DMK në ZRRE që mbështetet te mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike. KESCO në ankesë ka theksuar se nuk duhet të merret parasysh vetëm krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike të evidentuar nga DMK në ZRRE, pasi që konsumatori në periudha tjera si 10/2019, 11/2019 dhe 12/2019 ka shpenzim të ndryshëm në krahasim me shpenzimin e evidentuar nga DMK në ZRRE. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2009_12_19 i datës 16.12.2019 për konsumatorin N. H. me shifër DPR - 56321.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s korrigjimi plotësues i datës 28.07.2017 është korrigjim i saktë dhe real, bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi, pasi që njehsori elektrik ka regjistruar shpenzim të energjisë elektrike për 33.33% më pak, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe përkundër asaj që është theksuar se Departamenti i faturimit në KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës, atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit,



e që për konsumatorët shtëpiak përfshin periudhën gjashtë mujore, mirëpo Bordi i ZRRE gjithashtu thekson se në rastin e konsumatorit vërehet se nuk ka ndryshim në shpenzim të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, dhe se edhe sipas kodeve dhe procedurave në fuqi theksohet qartë se nuk mund të merret si meritore vetëm procesverbalin i kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.29/25 i datës 25.07.2017, pa u bërë edhe analizat tjera të shkresave të lëndës. Andaj Bordi i ZRRE thekson se me të drejtë organi i shkallës së parë në ZRRE ka konstatuar se KESCO është dashur të bëjë analiza të shpenzimit të energjisë elektrike për të vlerësuar se a ka pasur gabim në matje apo jo, dhe jo të bazohet vetëm në Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.29/25 i datës 25.07.2017.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s nuk duhet të merret parasysh vetëm krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike të evidentuar nga DMK në ZRRE, pasi që konsumatori në periudha tjera si 10/2019, 11/2019 dhe 12/2019 ka shpenzim të ndryshëm në krahasim me shpenzimin e evidentuar nga DMK në ZRRE, Bordi i ZRRE thekson se ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike për të vërtetuar konstatimet e organit të shkallës së parë të ZRRE lidhur me shpenzimin e energjisë elektrike, dhe konstaton se konstatimi i organit të shkallës së parë për krahasimin e shpenzimeve të energjisë elektrike është i saktë pasi që nuk ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me dy njehsorët elektrik. Bordi i ZRRE thekson se gjatë analizave të bëra shpenzimit të energjisë konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Bazuar në analizën e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik nr.45448420 dhe njehsorin e ri elektrik nr.67786868 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se nuk ka ndryshim të shpenzimeve përkatësisht nuk ka rritje të shpenzimit. Mesatarja mujore e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.45448420 për periudhën 12/2015 deri në periudhën 05/2016 është 471 kWh/muaj, periudhën 12/2016 deri në periudhën 05/2017 është 358 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.67786868 periudha 12/2017 deri në periudhën 05/2018 është 406 kWh/muaj si dhe periudha 12/2018 deri në periudhën 05/2019 është 399 kWh/muaj. Bordi i ZRRE thekson se bazuar në krahasimet e të shpenzimeve të energjisë elektrike të bëra, konstatohet se nuk ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me dy njehsorët elektrik, e që po që do kishte mos matje të saktë të shpenzimit të energjisë elektrike ashtu siç është theksuar në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.29/25 të datës 25.07.2017, atëherë pas rregullimit të pikës matëse shpenzimi i energjisë elektrike do të rritej, por që në rrjedhën e energjisë elektrike nuk është vërejtur se kemi rritje të shpenzimit të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE thekson se pas analizave të bëra të gjitha shkresave të lëndës konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë të ZRRE ku është vendosur që KESCO duhet që konsumatorit me shifër DPR – 56321 t'i anulohet korrigjimin plotësues nr.90893DPR-56321 të datës 28.07.2017 në vlerë financiare 59.93€, është plotësisht i saktë dhe i drejtë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithshme pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundohet versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit N. H. dhe
- Arkivit të ZRRE-së